



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE

Nr. 8295 prot.

Tiranë, më 26.06.2023

Lënda: *Kthim përgjigje kërkesës për leje të veçantë*

Drejtuar: - Dhionisios Alfred Beleri
IEVP "Jordan Misja"
- Av.Geni Gjyzari ✓

Për dijeni: Zt. Altin DUMANI

Drejtues i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, është administruar shkresa Prokurë Nr.991, datë 13.06.2023 e Avokat Geni Gjyzari, me nr.Liçense 2739 dhe NIPT L46419203J dhe shkresa Nr.2850/22, datë 21.06.2023 e Këshillit Bashkiak Himarë, të ardhur me email më datë 23.06.2023, ora 12.56.

Nëpërmjet emailit njoftohemi se;

Sekretarja e Këshillit Bashkiak Himarë ka njoftuar kërkuesin, me cilësinë e Kryetarit të zgjedhur të Bashkisë Himarë, se në datën 27.06.2023 ora 11, në ambientet e sallës së stadiumit "Petro Ruci" Himarë, do të zhvillohet mbledhja e parë e Këshillit të Bashkisë Himarë. Në rendin e ditës është edhe ceremonia e marrjes së detyrës së Kryetarit të Bashkisë Himarë, përfshirë edhe ceremoninë e betimit të tij.

Bazuar në nenin 8 të ligjit 81/2020, kërkuesi gëzon të gjitha të drejtat të cilat nuk i janë kufizuar me vendimin me të cilin është caktuar masa e sigurimit "arrest në burg" ndaj tij dhe referuar vendimeve gjyqësore të cituara më lart nuk rezulton që ndaj kërkuesit të jetë marrë masë sigurimi ndaluese, apo t'i jetë ndaluar e drejta për t'u zgjedhur.

Duke patur parasysh praktikën e ndjekur në rastin e deputetit Mark Froku, i cili me kërkesë të Kuvendit Popullor, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, me shkresën 115/4 prot., datë 01.04.2015 të Prokurorisë së Përgjithshme i është dhënë "Autorizim për leje të veçantë" për të marrë pjesë në seancën parlamentare të datës 02.04.2015 të Kuvendit të Shqipërisë, kërkojmë që edhe kërkuesi Dhionisios Alfred Beleri të pajiset me një "Autorizim" të tillë, me qëllim marrjen pjesë të kërkuesit në këtë mbledhje, duke qënë se është e domosdoshme prania e tij.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE

Nr. 8295 prot.

Tiranë, më 26.06.2023

Lënda: *Kthim përgjigje kërkesës për leje të veçantë*

Drejtuar:

- Dhionisios Alfred Beleri
- IEVP "Jordan Misja"
- Av.Geni Gjyzari ✓

Për dijjeni: Zt. Altin DUMANI

Drejtues i Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

Në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, është administruar shkresa Prokurë Nr.991, datë 13.06.2023 e Avokat Geni Gjyzari, me nr.Liçense 2739 dhe NIPT L46419203J dhe shkresa Nr.2850/22, datë 21.06.2023 e Këshillit Bashkiak Himarë, të ardhur me email më datë 23.06.2023, ora 12.56.

Nëpërmjet emailit njoftohemi se;

Sekretarja e Këshillit Bashkiak Himarë ka njoftuar kërkuesin, me cilësinë e Kryetarit të zgjedhur të Bashkisë Himarë, se në datën 27.06.2023 ora 11, në ambientet e sallës së stadiumit "Petro Ruci" Himarë, do të zhvillohet mbledhja e parë e Këshillit të Bashkisë Himarë. Në rendin e ditës është edhe ceremonia e marrjes së detyrës së Kryetarit të Bashkisë Himarë, përfshirë edhe ceremoninë e betimit të tij.

Bazuar në nenin 8 të ligjit 81/2020, kërkuesi gëzon të gjitha të drejtat të cilat nuk i janë kufizuar me vendimin me të cilin është caktuar masa e sigurimit "arrest në burg" ndaj tij dhe referuar vendimeve gjyqësore të cituara më lart nuk rezulton që ndaj kërkuesit të jetë marrë masë sigurimi ndaluese, apo t'i jetë ndaluar e drejta për t'u zgjedhur.

Duke patur parasysh praktikën e ndjekur në rastin e deputetit Mark Frroku, i cili me kërkesë të Kuvendit Popullor, drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme, me shkresën 115/4 prot., datë 01.04.2015 të Prokurorisë së Përgjithshme i është dhënë "Autorizim për leje të veçantë" për të marrë pjesë në seancën parlamentare të datës 02.04.2015 të Kuvendit të Shqipërisë, kërkojmë që edhe kërkuesi Dhionisios Alfred Beleri të pajiset me një "Autorizim" të tillë, me qëllim marrjen pjesë të kërkuesit në këtë mbledhje, duke qënë se është e domosdoshme prania e tij.

Sa më sipër Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, sot më 26.06.2023, shqyrtoi kërkesën për leje të veçantë të shtetasit **Dhionisios Alfred Beleri**, me masë arrest me burgim dhe konstaton:

Në nenin 73, të Ligjit 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, parashikohet se “i burgosuri ka të drejtë të përfitojë leje të veçantë në rast të sëmundjeve të rënda, të cilat rrezikojnë jetën e anëtarëve të familjes, të vërtetuar me raport mjekësor, ose të ngjarjeve të rëndësishme familjare, si vdekje, lindje ose martesë, si dhe në rastet e dhënies së provimeve të vetë të dënuarit. Kjo periudhë përfshihet në kohën e vuajtjes së dënimit”.

Pra kërkesa e dërguar nga Avokati Geni Gjyzari, për leje të veçantë të klientit të tij, nuk parashikohet në ligj dhe si e tillë refuzohet.

Faleminderit

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

ADMIR ABRIJA

